

**AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TIRANA TRANS 22” SH. P.K**

Sot, me date 18.02.2022, une i nenshkruari:

Znj. RUDINA KAPAJ, e bija i Faruk e Fatbardha, i datelindjes 14.01.1972, lindur ne Berat, dhe banues ne Tirane, i identifikuar nga pasaporta me nr. Personal H25114087U, shtetas shqiptar, madhore e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Ne perputhje me ligjin 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “**TIRANA TRANS 22**” Sh.p.k.(me poshte referuar si “Shoqeria”), duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “**TIRANA TRANS 22**” Sh.p.k.

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Bulevardi Zogu i Pare, Godina Nr.2, Kati 1, Tirane Shqiperi .

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendres Kombetare te Biznesitt (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Aktivitet ne fushen e transportit urban interurban dhe nderkombetar te udhetareve dhe mallrave per te trete dhe me qira me mjete te transportit tokesor dhe detar,transport te personelit te kompanive te ndryshme, sherbim Taksi , sherbim postar, shitblerje e automjeteve te reja dhe te perdorura. Ekspert dhe import i mjeteve, celje te agjensive te transportit te udhetare edhe mallrave, shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit me te gjitha llojet e mjeteve te transportit, celjen e agjensive turistike ne fushen e turizmit dhe udhetimeve turistike. Sherbim servisi te automjeteve te transportit (autovetura, autobuze, kamione etj). Sherbim servisi te automjeteve te renda te ndertimit, parkim automjetesh, lavazho automjetesh., autoshkolle etj. Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu edhe aktivite te tjera ndihmese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ky aktivitet do te ushtrohet pas marjes se licences.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) Leke, i zoteruar 100% nga ortaku i vetem i saj **RUDINA KAPAJ**

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 1 (nje) pjese kapitali, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara, me vleren prej 100.000 (njqind mije) Leke secila.

Neni 6

Derdhja e kapitalit themeltar eshte bere prane Bankes.

Neni 7

Pjeset e kapitalit jane te transferueshme ndaj te treteve teresisht apo pjeserisht, sipas procedurave te parashikuara ne Statutin e shoqerise.

Neni 8

Shoqeria administrohet nga Administratori i shoqerise **RUDINA KAPAJ** shtetase shqiptar, e bija e Faruk e Fatbardha, e datelindjes 14.01.1972, lindur ne dhe banuese ne Rruga "Andon Zako Cajupi", Tirane , e identifikuar nga leternjoftimi me nr. Personal H25114087U, madhore e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

Administratori emerohet per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperseritjeje.

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Vendimit te Ortakut te Vetem. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Adminstratori.

Neni 9

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 10

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe, nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise,

ORTAKU I VETEM

I SHOQERISE "TIRANA TRANS 22" SH P K

RUDINA KAPAJ

